

V E N D I M
Nr.606, datë 30.10.1995

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR NDËRMJETËSIM PËR PUNËSIM DHE KUALIFIKIM
NËPËRMJET PUNËSIMIT JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË
SHTETASVE SHQIPTARË**

Në zbatim të nenit 19 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.7939, datë 25.5.1995 “Për migracionin”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë u jep leje për ndërmjetësim për punësim e kualifikim nëpërmjet punësimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të shtetasve shqiptarë, personave juridikë dhe fizikë privatë, vendas ose të huaj.

2. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë mund të përcaktojë vlefshmërinë e lejes për ndërmjetësim për disa ose vetëm për një shtet të caktuar, për një periudhë kohe deri në një vit. Ajo mund ta përsëritë atë, kur përligjet motivi për të cilin është dhënë.

3. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë mbikëqyr veprimëtarinë e ndërmjetësimit të personave juridikë e fizikë privatë, vendas ose të huaj, për t’u siguruar që ky ndërmjetësim bëhet në pajtim me legjislacionin shqiptar të punës dhe të vendit ku shtetasit shqiptarë do të punësohen a kualifikohen nëpërmjet punësimit.

4. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, në rastet e shkeljes së legjislacionit shqiptar të punës, ushtron të drejtën e heqjes së lejes për ndërmjetësim.

5. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë u jep leje për ndërmjetësim për punësim e kualifikim nëpërmjet punësimit, personave juridikë e fizikë privatë, vendas ose të huaj, pas shqyrtimit të dokUmentacionit që duhet të paraqitet për të provuar se ata janë në gjendje të realizojnë punësimin dhe kualifikimin nëpërmjet punësimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të shtetasve shqiptarë.

6. Dokumentacioni i nevojshëm që duhet t’i paraqitet ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë:

a) Autorizim nga Administrata Shtetërore e Punës, agjenci private punësimi ose kompani, që lejon ndërmarrjen e ndërmjetësimit për punësim.

b) Pasaportë (fotokopje e legalizuar), fotografi 4 copë 4 x 6.

c) Dëshmi penaliteti.

ç) Dokumenti shkollor.

d) Vendimi i gjykatës për njohjen dhe regjistrimin si person.

dh) Autobiografi personale.

e) Prokurë përfaqësimi në rast se këto procedura ndërmjetësimi i kalojnë një personi tjetër.

ë) Përshkrimi i hollësishëm i mundësive dhe fushat e caktuara për punësimin e shtetasve shqiptarë.

7. Për marrjen e lejes paguhet një kuotë prej 5000 lekësh.

8. Të gjitha dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.

9. Ngarkohet Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë të nxjerrë udhëzime në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi